



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR QË DO TË ORGANIZOJË PUNËN PËR
PARAQITJEN E Z. FRAN MOLLA SI KANDIDAT I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT NË
ZONËN ZGJEDHORE TIRANË, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Regjistrimi i Komitetit Nismëtar për organizmin e punës për paraqitjen e z. Fran Molla si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

Baza Ligjore: Neni 70, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 ka caktuar datën 30 Qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Bazuar në përcaktimet e nenit 70, të Kodit Zgjedhor, z. Lulash Aroni, z. Ndue Kolndreu, znj. Danjela Molla, znj. Flora Selja, znj. Gjyste Molla, z. Besmir Molla, znj. Ermelinda Molla, z. Mirsim Jella i janë drejtuar KQZ-së me kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar të formuar prej tyre. Kërkesa e paraqitur prej tyre është administruar me nr. 2480 prot., datë 20.04.2019.



Nr. 233 i Vendimit Data 27.04.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për regjistrimin e Komitetit Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Fran Molla si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në Zonën Zgjedhore Tiranë, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019

Kërkuesit shprehen se janë zgjedhës të zonës zgjedhore Bashkia Tiranë, dhe me vullnet të lirë kanë vendosur krijimin e Komitetit Nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin z. Fran Molla.

Kërkuesit e kanë paraqitur kërkesën e tyre duke, depozituar emrat dhe nënshkrimet e tyre në të, si dhe i kanë bashkëlidhur kërkesës kopje të letërnjoftimit.
Nga verifikimi i emrave të kërkuesve në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, rezulton se, të nëntë figurojnë si zgjedhës, të Bashkisë Tiranë.

Në këto kushte, kërkesa e paraqitur prej këtyre zgjedhësve, respekton kriterin e afatit e përcaktuar në nenin 70 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, gjithashtu respekton edhe pikën 3 të nenit 70 që parashikon së grupi nismëtar krijohet nga jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore që do paraqesin kandidatin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas verifikimeve përkatëse dhe konstatimit se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur janë në përputhje me kriterin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 70 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të regjistrojë Komitetin Nismëtar, i cili do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Fran Molla, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 233 i Vendimit Data 27.04.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit

Për regjistrimin e Komitetit Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Fran Molla si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në Zonën Zgjedhore Tiranë, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019